



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

**RREGULLORE (P) NR. 01/2018 PËR PROCESIN E
PROPOZIMIT TË EMËRIMIT TË AUDITORIT TË
PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Prishtinë, 29 mars 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 pika (4) dhe nenit 136 (3 dhe 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), dhe nenit 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për strukturën organizative të Presidencës (08.09.2016), si dhe duke marr parasysh nenin 4 (4) të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 17, 10 qershor 2016), miraton:

**RREGULLORE (P) NR. 01/2018 PËR PROCESIN E PROPOZIMIT
TË EMËRIMIT TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohet:
 - 1.1. procesi i përzgjedhjes së kandidatit për pozitën e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës; si dhe
 - 1.2. procesi i propozimit, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, për emërimin dhe shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet, nga:
 - 1.1. Komisioni Përzgjedhës;
 - 1.2. njësitë përkatëse të Presidencës, si dhe
 - 1.3. personat që aplikojnë për Auditor të Përgjithshëm.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Auditor i Përgjithshëm** – Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Komision Përzgjedhës** – Komisioni i caktuar nga Presidenti, për administrimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Auditor të Përgjithshëm;
 - 1.3. **Kushtetutë** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. **Kuvend** – Kuvendi i Republikës së Kosovës;
 - 1.5. **Ligj** – Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 17, 10 qershor 2016);
 - 1.6. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
 - 1.7. **Sekretar** – Sekretari i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.8. **Zyrë** – Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Ligjit.

KAPITULLI II – PROCESI I PËRZGJEDHJES SË KANDIDATIT PËR AUDITOR TË PËRGJITSHËM

Neni 4 **Përzgjedhja e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm**

Përzgjedhja e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm bëhet pas një procesi të hapur, të paanshëm, transparent dhe pas intervistimit të administruar nga Komisioni Përzgjedhës i caktuar nga Presidenti.

Neni 5 **Njoftimi**

Sekretari, njofton Shefin e Stafit të Presidentit, gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Auditorit të Përgjithshëm apo kurdo që pozita e Auditorit të Përgjithshëm mbetet e zbrazët.

Neni 6 **Shpallja e Konkursit Publik**

1. Sekretari, në bashkëpunim me Shefin e Stafit të Presidentit, fillon procedurën për përzgjedhjen e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm, dhe autorizon shpalljen e Konkursit Publik.
2. Konkursi Publik shpallet në së paku dy gazeta ditore në Republikën e Kosovës dhe në ueb-faqen e Zyrës.
3. Konkursi Publik do të jetë i hapur tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit.

Neni 7 Kriteret

1. Auditori i Përgjithshëm, siç është përcaktuar në nenin 4 (5) të Ligjit, duhet të jetë një person i cili posedon kualifikimet e kërkuara, me moral të lartë, i paanshëm, i ndershëm, dhe me integritet për kryerjen e funksionit, si dhe:
 - 1.1. duhet të posedojë diplomë universitare dhe përvojën e duhur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, financave publike ose administratës publike për jo më pak se tetë (8) vite, nga të cilat duhet të jenë katër (4) përvojë menaxheriale;
 - 1.2. nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të veprës penale, nuk është nën procedurë penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale.
 - 1.3. nuk është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tre (3) vjeçare, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik.

Neni 8 Dokumentet për aplikim

1. Me rastin e aplikimit për Auditor të Përgjithshëm, duhet të dorëzohen:
 - 1.1. letër motivimi, e cila përfshinë përshkrim të shkurtër për vizionin e zhvillimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (maksimum 500 fjalë);
 - 1.2. *Curriculum Vitae*;
 - 1.3. dëshmi për përgatitjen shkollore dhe profesionale (kopjet e diplomave);
 - 1.4. dëshmi për përvojën e punës;
 - 1.5. dokument identifikimi (kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës);
 - 1.6. dëshmi, që nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të veprës penale, nuk është nën procedurë penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale;
 - 1.7. deklaratë nën betim, se nuk është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tre (3) vjeçare, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik, sipas Shtojcës Nr. 1, të kësaj Rregulloreje.

Neni 9 Aplikimi

Aplikimi për Auditor të Përgjithshëm bëhet përmes postës, apo drejtpërdrejtë në Zyrë, brenda afatit të paraparë në Konkursin Publik.

Neni 10 Themelimi dhe përbërja e Komisionit Përzgjedhës

1. Presidenti me Vendim emëron Kryesuesin dhe Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, pas shpalljes së Konkursit Publik për Auditor të Përgjithshëm.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit Përzgjedhës duhet të jenë apariat.
3. Komisioni përbëhet nga së paku 5 (pesë) anëtarë, i cili përfshinë por nuk kufizohet në:
 - 3.1. një (1) përfaqësues nga Zyra;
 - 3.2. Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit;
 - 3.3. një (1) përfaqësues nga stafi akademik i fushës ekonomike;
 - 3.4. Guvernatorin apo njërin nga Zëvendës Guvernatorët e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës; dhe
 - 3.5. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.
4. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës ka konflikt të interesit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, atëherë ai/ajo e njofton Presidentin dhe nuk merr pjesë në punën e Komisionit. Në rastet e tilla, Presidenti cakton një përfaqësues tjetër nga i njëjti institucion.

Neni 11

Mbështetja e punës së Komisionit Përzgjedhës

1. Komisioni Përzgjedhës mbështetet nga Koordinatorin i Komisionit, i cili emërohet nga Sekretari.
2. Koordinatorin është përgjegjës për mbështetjen teknike dhe administrative të Komisionit Përzgjedhës.

Neni 12

Detyrat e Komisionit Përzgjedhës

1. Detyrat e Komisionit Përzgjedhës, janë:
 - 1.1. administrimi i procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Auditor të Përgjithshëm;
 - 1.2. intervistimi i kandidatëve që kanë aplikuar për Auditor të Përgjithshëm;
 - 1.3. përgatitja e raportit të veçantë me shkrim për Presidentin, i cili përmban emrat e tre (3) kandidatëve për të cilët Komisioni Përzgjedhës ka vlerësuar se i plotësojnë kushtet si më të kualifikuarit për tu propozuar për Auditor të Përgjithshëm.

Neni 13

Raportit i Komisionit Përzgjedhës

1. Puna e Komisionit Përzgjedhës përfundon me dorëzimin e Raportit tek Presidenti.
2. Raporti nënshkruhet nga Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit Përzgjedhës.

Neni 14

Vendim i Presidentit

1. Presidenti vendos që njërin prej tre (3) kandidatëve të rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës për Auditor të Përgjithshëm, t'ia propozojë Kuvendit për emërim,

në pajtim me nenin 136 (3) të Kushtetutës dhe nenin 4 (4) të Ligjit apo vendos të rishpall Konkursin Publik, në mungesë të kandidatëve të përshtatshëm për atë pozitë.

2. Rezultatet e përzgjedhjes bëhen publike, përmes ueb faqes së Zyrës

KAPITULLI III – PROPOZIMI I PRESIDENTIT PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 15

Propozimi i Presidentit për emërim

Propozimit të Presidentit drejtuar Kuvendit për emërimin e Auditorit të Përgjithshëm, i bashkëngjitet dokumentacioni përcjellës për kandidatin e propozuar për Auditor të Përgjithshëm.

Neni 16

Propozimi i Presidentit për rizgjedhje

Në pajtim me nenin 136 (5) të Kushtetutës, Presidenti mund t'i propozoj Kuvendit rizgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm edhe për një mandat.

Neni 17

Propozimi i Presidentit për shkarkim

Presidenti, i propozon Kuvendit shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm, siç është përcaktuar në nenin 136 (4) të Kushtetutës.

KAPITULLI IV – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Buxheti

Sekretari siguron buxhetin e nevojshëm, për punën, angazhimin, pjesëmarrjen në takime si dhe funksionimin e përgjithshëm të Komisionit Përzgjedhës.

Neni 19

Kompensimi

1. Kryesuesi, anëtarët dhe koordinatori i Komisionit Përzgjedhës gëzojnë të drejtën e kompensimit.

2. Kompensimi i kryesuesit, anëtarëve dhe koordinatorit të Komisionit Përzgjedhës përcaktohet me vendim të Sekretarit.

Neni 20

Shtojca

Pjesë e kësaj rregulloreje është Shtojca Nr. 1: Deklarata nën Betim.

Neni 21
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës, Nr. DAB – 001 – 2015 për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për të propozuar për Auditor të Përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës (05.03.2015).

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit me dekret nga ana e Presidentit.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 29 mars 2018.

Miratuar me dekretin Nr. DNJ-01-2018,
datë 29.03.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi

Shtojca Nr. 1 – Deklarata nën Betim



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNIKA

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, _____, me numër personal _____, deklaroj se nuk jam dhe nuk kam qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik gjatë periudhës tre (3) vjeçare, para datës së aplikimit për Auditor të Përgjithshëm.

Emri dhe Mbiemri:	Nënshkrimi:

Vendi: _____

Data: _____._____.20__.